



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ prot.

Shkodër, më _____._____. 2025

Lënda: *Kthim përgjigjeje*

Të nderuar,

Në përgjigje të kërkesës suaj për informim, ju bëjmë me dije si më poshtë:

1. A është konsultuar me publikun Buxheti Vjetor 2024 dhe 2025 i Bashkisë? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjësive publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura, kopje të rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

Po, Buxheti Vjetor 2024–2025 është konsultuar me publikun.

Të gjitha njoftimet, procesverbalet dhe dokumentacioni përkatës i konsultimit publik janë publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër, konkretisht në lidhjet e mëposhtme:

<https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/Njoftim-per-keshillim-me-publikun-drafti-PBA-2025-2027.pdf>

https://bashkiashkoder.gov.al/k%C3%ABshillim_m_publikun/njoftim-per-keshillim-me-publikun-per-draftin-e-projektplanit-buxhetor-afatmesem-2026-2028/

<http://209.95.59.218/~bsh/regjistr bashkiashkoder/wp-content/uploads/2024/12/Permbledhje-e-rekomandimeve-dhe-proces-verbalet-e-konsultimit-publik-buxheti-Shkoder-2024.pdf>

2. A janë njoftuar paraprakisht në faqen e internetit ose në stendën e njoftimeve publike, njoftimi për organizimin e seancave për konsultimin publik për periudhën Janar 2025–Dhjetor 2025? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre mbledhjeve, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

Po, **njoftimet dhe dokumentacioni përkatës për konsultimet publike** janë publikuar paraprakisht dhe janë të aksesueshme në **Regjistrin Elektronik të Projektakteve**, në adresën:

<http://209.95.59.218/~bsh/regjistr bashkiashkoder/regjistri-i-projekt-akteve/>

3. A është konsultuar me publikun paketa e taksave dhe tarifave vendore për periudhën 2024-2025? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjësive publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura, kopje të rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

Po, **Paketa e Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 2024–2025 është konsultuar me publikun.**

Dokumentacioni përkatës është publikuar në lidhjet e mëposhtme:

<https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/Njoftim-per-konsultim-publik.pdf>

<http://209.95.59.218/~bsh/regjistr bashkiashkoder/wp-content/uploads/2025/11/Pr.verbal-Degjesa-publike.-Paketa-fiskale.pdf>

4. A është konsultuar me publikun tjetërsimi i pronave të Bashkisë për periudhën Janar 2025-Dhjetor 2025? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjësive publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura, kopje të rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

Gjatë periudhës **2024–2025**, Bashkia Shkodër **nuk ka pasur vendimmarrje që lidhen me tjetërsimin e pronave**, për rrjedhojë nuk ka pasur procese konsultimi publik për këtë çështje.

5. A janë njoftuar paraprakisht në faqen e internetit ose stendën e informimit data dhe ora e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar 2025 - Dhjetor 2025? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre mbledhjeve, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

Po, **datat dhe oraret e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak** janë njoftuar paraprakisht dhe janë publikuar në **Regjistrin Elektronik të Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak**, në adresën:

<http://209.95.59.218/~bsh/regjistr bashkiashkoder/regjistri-i-mbledhjeve-te-keshillit-bashkiak/>

6. A janë njoftuar paraprakisht në faqen e internetit ose stendën e informimit data dhe ora e mbledhjeve të Komisioneve të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar 2025 - Dhjetor 2025? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre mbledhjeve, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

Po, **mbledhjet e Komisioneve të Këshillit Bashkiak** janë njoftuar paraprakisht dhe janë të publikuara në të njëjtin regjistër elektronik:

<http://209.95.59.218/~bsh/regjistr bashkiashkoder/regjistri-i-mbledhjeve-te-keshillit-bashkiak/>

7. A shfaqen në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike, njoftime për organizimin e Dëgjesave Publike nga Këshilli Bashkiak për periudhën Janar 2025 - Dhjetor 2025? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre dëgjesave, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

Po, **njoftimet dhe dokumentacioni për dëgjesat publike** janë publikuar në **Regjistrin Elektronik të Projektakteve**, në adresën:

<http://209.95.59.218/~bsh/regjistr bashkiashkoder/regjistri-i-projekt-akteve/>

Çdo informacion i kërkuar nga ana juaj është i publikuar në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër dhe të Këshillit Bashkiak.

Njoftimet për mbledhjet e Komisioneve dhe të Këshillit Bashkiak, si dhe njoftimet për zhvillimin e konsultimeve publike, janë të publikuara gjithashtu në faqen zyrtare të Këshillit Bashkiak në rrjetin social Facebook.

Gjithashtu, njoftimet për mbledhjet e Këshillit Bashkiak u përcillen mediave lokale në mënyrë të rregullt, përmes aplikacionit WhatsApp.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KRYETAR

Oltion LULI